



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žulbe i Predstavke**

**Anr.685/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**HUDHET** e palejuar ankesa Anr.685/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.685/2021 nga Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, me të cilën pretendon se në fshatin Verboc, në qendrat e votimit 0325e/01R dhe 0325e/02D nuk i kanë figuruar votat pas procesit të numërimit. Ankesës i ka bashkangjitur deklaratat e familjarëve që e kanë votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

#### **Ankesa është e palejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga

KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc nuk e paragjykon çështjen dhe se ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.685/2021 më datën 20.10.2021

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**